



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UJËSJELLËS KANALIZIME DURREËS SH.A.**

Nr. _____ Prot

Durrës, më ___ / ___ /2022

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës – Mallra

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Blerje materiale kancelarie dhe të ngjashme”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

Pajisje zyre përveç mobiljeve

KODI CPV 30191000-4

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor UKD sha ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

Argumentimi i fondit limit : Perlllogaritja e vleres se fondit limit eshte bere referuar Nenit 35 te ligjit nr.162/2020, si dhe nenit nr.13 dhe nenit nr.76 te VKM 285 date 19.05.2021.

I. KRITERET E VECANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 3;

b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit sipas Shtojcës 8

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Sipas formularit përmbledhës të vetdeklarimit

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare **2019, 2020 dhe 2021** ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se se **40%** të vlerës së parashikuar të kontratës.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Sipas nenit 43, pika 2, gërma c) e VKM nr. 285, datë 19.05.2021 për MRRPP, vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë 40 % të vlerës së parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar, dhe në procedurat e prokurimit “Shërbim konsulence”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 29, të Ligjit Nr.8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2019, 2020 dhe 2021 të konfirmuara nga administrata tatimore, ku të paktën në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit”.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, nenin 9, të Ligjit Nr.25/2018, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

Kapaciteti teknik

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e zhvillimit të procedurës, në një vlerë jo më të vogël se **20 %** të vlerës së së fondit të limitit të përlogaritur të kontratës që prokurimet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik ose fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” neni 40, pika 4 si dhe neni 55, pika 4/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë **Çertifikatë ISO 9001:2015** (ose ekuivalente), lidhur me sistemin e menaxhimit të cilësisë, e cila të përfshijë objektin e prokurimit, si dhe të jetë e vlefshme. Certifikata duhet të jetë e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit i vendit ose nga organizma ndërkombëtarë akreditues të njohur nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit në Shqipëri (DPA).

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar nën të 36 dhe 79, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nënve 40, pika 8, dhe 44, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mundësi të ekzekutimit të objektit të prokurimit.

AK, bazuar në dispozitat më sipër cituar dhe kërkesat e specifikimeve teknike, dhe preventivit të furnizimeve, ka kërkuar paraqitjen e dokumentacionit (Certifikatat ISO) dëshmuar të pajtueshmërisë së ofertuesit me standardet e kërkuara të cilësisë, përfshirë edhe standardet për menaxhimin e mjedisit. Certifikatat ISO të kërkuara nga AK lidhen ngushtësisht me objektin e kontratës dhe specifikën e furnizimit të shtjelluara dhe zgjidhura në preventivin përkatës.

Në vijim shtjellohen certifikatat ISO të kërkuara nga AK.

ISO 9001 parashikon një tërësi rregullash që garantojnë një bazë rreziku parandalues ndaj cilësisë e cila mbulon një gamë të gjerë të çështjeve ku përfshihen: angazhimi i lartë i menaxhimit për cilësi nga furnizuesi, fokusin e klientit, përshtatshmërinë e burimeve të tij, kompetencen/profesionalizmin e punonjësve, procesin e menaxhimit (për prodhim, ofrimin të shërbimeve dhe proceset mbështetëse e administrative), planifikimin e cilësisë, dizajnimi i produkteve dhe shërbimet që ofron, garantimin e një procesi cilësor të furnizimit, sigurimin e konformitetit për mallrat dhe shërbimet, proceset e tij për të zgjidhur ankesat e konsumatorëve, veprime korrigjuese, dhe një kërkesë për të nxitur përmirësimin. Kjo kërkesë, dëshmon se mbajtësi i saj garanton standardet ndërkombëtare të menaxhimit të cilësisë së ushtrimit të aktivitetit tregtar të tij.

Që një subjekt të jetë i pajisur me certifikatën ISO 9001, do të thotë se ky subjekt ka plotësuar kërkesat e këtij standardi mbi ”Sistemet e menaxhimit të cilësisë”. ISO 9001:2015 specifikon kërkesat për një sistem cilësor të menaxhimit të cilësisë, kur një organizatë:

- duhet të dëshmojë kapacitetin për të siguruar vazhdimisht produktin që kënaq klientin dhe kërkesat statutores dhe normative të aplikueshme.
- synon të përmirësojë kënaqjen e klientit, nëpërmjet aplikimit të sistemit, duke përfshirë proceset për përmirësimin e vazhdueshëm të sistemit dhe garancisë të konformitetit me klientin dhe kërkesat statutores dhe normative të aplikueshme.

2.4 Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

2.4.1 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë për produktin Letër A4 80g/m², fotografi / katalogë / ose fragmente (faqe) të katalogut/eve, ku të shprehen qartë për lloj e letrës që oferton si dhe të dhënat sipas specifikimeve teknike. Në rastin kur fotografia / katalogu është në gjuhën shqipe dhe origjinal nuk ka nevojë të përkthehet apo noterizohet, por duhet të jetë i përkthyer në shqip e noterizuar, në rastin kur është në gjuhë të huaj.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar nenin të 36, dhe 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 6/b dhe 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Autoriteti kontraktor është në të drejtën e tij të bazuar në legjislacionin e prokurimit publik dhe aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij si më sipër cituar, për të kërkuar kataloget teknik te mallrave objekt prokurimi, për verifikimin e përputhshmërisë së tyre me specifikimet teknike, të cilat edhe këto nga ana tjetër duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit kontraktor.

2.4.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë vertetim/deklarate/autorizim nga prodhuesi ose te distributorit te autorizuar për /artikullin “Leter A4 80g/m²”. Dokumentat duhet të përmbajnë të dhëna të plota si: telefoni/e-mail/website, të nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar nenin të 36, dhe 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 6 dhe 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Paraqitja e autorizimit te prodhuesit ose vertetimit ose dokumentit ose autorizimit të distributorit të autorizuar për furnizimin e mallrave qe do te ofertohe, është kërkesë e ligjore e domosdoshme, me qëllim që OE të kenë autorizimin për tregtimin e produkteve nga prodhuesi apo distributori i autorizuar, duke ofruar dhe garanci per mallrat qe do të furnizohen.

Për të shmangur kufizimin e konkurrencës dhe per të lehtësuar pjesëmarrjen e OE qe operojnë ne këtë fushë, autorizimi eshte kërkuar vetëm per një artikull atë të “Letrës A4 80g/m²”, e cila ka edhe peshën kryesore në këtë procedurë dhe nje vlerë të konsiderushme.

Për nga vetë natyra e veçante e procedurës se prokurimit, me qëllim realizimin e kontratës qe prokurohet, kriteri i sipërcituar është një kërkesë e nevojshme që lidhet drejtpërdrejt me rëndësinë dhe natyrën e objektit qe prokurohet dhe që mund te plotësohet nga çdo operator ekonomik, cili ka kapacitetet e nevojshme për realizimin e procedurës.

2.4.3 Operatoret ekonomike pjesemarres ne kete procedure duhet qe ditën dhe oren e hapjes se ofertave, te paraqesin mostra per artikujt me nr rendor: 1, 3, 4, 5, 11, 13, 15, 17, 25, 26, 27, 30, 31, 33, 34 të listes se artikujve. ***Mosparaqitja e mostrave është kusht për skualifikim.***

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar nenin të 36, dhe 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 6/a dhe 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Paraqitja e mostrave të kërkuara lidhet drejtpërdrejtë me verifikimin e përputhshmërisë së specifikimeve teknike të produkteve të ofruara nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës, me ato të kërkuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit.

Autoriteti Kontraktor është në të drejtën e tij të bazuar në legjislacionin e prokurimit publik dhe akteve nënligjorë të nxjerra në zbatim të tij, për të kërkuar mostrat e mallrave, objekt prokurimi, për verifikimin e përputhshmërisë së tyre me specifikimet teknike, ato janë përzgjedhur për artikujt që kanë sasi të konsiderueshme të cilët janë më të kërkuarit.

Qëllimi i vendosur nga ligjvënësi për paraqitjen e mostrave, është dhënia e mundësisë autoritetit kontraktor, i cili është përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, të kryerjes së verifikimeve (ekzaminim, inspektim, testim) të mostrave të dorëzuara nga operatori ekonomik në rast se këto të fundit janë në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor të pasqyruar në specifikimet teknike të procedurës së prokurimit.

Specifikimet e letrës:

1	Pesha per letren A4 te bardhe	Sipas pershkrimit perkates ne tabele.
2	Lagështia	3-5 %
3	Trashësia	103-115 µm
4	Drita	≥ 93%
5	Shkëlqimi	101-115 %
6	CIE Bardhësia	CIE 152-170 %
7	Përmasat e letrës A4 210*297 mm	
8	Letra A4 të mos shkaktojë bllokimin e makinës fotokopjuese/printerin	
9	Të qëndrojnë e rrafshët pas kopjimit/printimit	
10	Të mos lëshojë pluhur letre në makinën fotokopjuese/printer	
11	Të jetë e lëmuar dhe e rëndë	
12	E përshtatëshme për printim në të dy anët	
13	Të përballojë shpejtësinë e printimit jo më pak se 120-130 faqe në minutë	
14	Nuk pranohet leter e ricikluar.	
15	Amballazhimi ne risma me 500 fije letër / kuti me 5 risma.	

1	Pesha per letren A3 te bardhe	Sipas pershkrimit perkates ne tabele.
2	Lagështia	3-5 %
3	Trashësia	103-115 µm
4	Drita	≥ 93%
5	Shkëlqimi	101-115 %
6	CIE Bardhësia	CIE 152-170 %
7	Përmasat e letrës A3 420*297 mm.	

8	Letra A3 të mos shkaktojë bllokimin e makinës fotokopjuese/printerin
9	Të qëndrojnë e rrafshët pas kopjimit/printimit
10	Të mos lëshojë pluhur letre në makinën fotokopjuese/printer
11	Të jetë e lëmuar dhe e rëndë
12	E përshtatëshme për printim në të dy anët
13	Nuk pranohet leter e ricikluar.

Specifikimet e tonerave:

- Numri serial i kutisë duhet të jetë i njëjtë me numrin serial të bojës
- Bojrat të kenë afat skadence jo më pak se 1 vit nga momenti i lëvrimit të mallit.
- Tonerat të jenë të shoqeruara me pulle sigurie nga prodhuesi ose ekuivalente të tyre dhe me part number-at e kerkuara nga AK. Emri i prodhuesit të jetë i stampuar në kutinë e bojës (dhe jo me etikete), në pullën e sigurisë dhe në kartrixhe, dhe të jetë i njëjti emër prodhuesi në paketimin e bojës, në pullën e sigurisë dhe në kartrixhe.
- Numri serial i kutisë duhet të jetë i njëjtë me numrin serial të bojës.
- Bojrat duhet të jenë origjinale ose ekuivalente, të përshtatura për llojet e printerave, të mos jenë të rimbushura (Recondition); të mos jenë të ricikluara (Remanufactured); të mos jenë të riprodhuara; të jenë të paketuara e të pahapura.

Lëvrimi i mallit do të jetë 30 ditë nga lidhja e kontratës.

Lista e materialeve:

NR	Emertimi I artikujve	Njesia	Sasia
1	Leter A4 80gr/m2	rizna/500fl	5000
2	Leter formati A3 80gr/m2	rizma/500fl	150
3	Zarfa plasmasi me vrima A4 100 micron. 3000 cope/kutia	KUTI	40
4	Mandat arketimi me 3 kopje	Cope	1500
5	Dosje A4 plastike me llastik dhe klip (kapese)	cope	2500
6	Dosje me kuti me mekanizem 5cm	cope	100

7	Dosje te thjeshta kartoni me llastik	cope	100
8	Dosje me buton 7-9 cm kartoni	cope	20
9	Dosje me buton 15 cm kartoni	cope	250
10	Dosje plastike me 80 qese brenda me kapak	cope	20
11	Dosje me buton, plastike, me gjeresi min 20 cm, me doreze.	cope	700
12	Stilo Rapid ngjyre blu	cope	50
13	Stilolaps xhel me suste dhe maje 0.7mm .Me gomine per mbajtje, me ngjyre blu me boje rezistente ndaj ujit,dhe me kapse xhepi metalike	cope	2500
14	Lapsa plumbi	cope	100
15	Marker I zi permanent	cope	500
16	Marker komplet me 4 ngjyra per tabe shenimesh	Kuti/4cp	100
17	Leter shenimesh me ngjitje permasa 101mm x 76mm (±2%), me 7 ngjyra te ndryshme, minimumi 280 fl.	cope	200
18	Korrektor stilo	cope	100
19	Makine Llogaritese Profesionale me permasa minimumi 205mm x 160mm x 40mm ,me cels per ndezje.	cope	10
20	Gershere te mesme minimumi 16.5cm	cope	50
21	Heqese telash stapleri	cope	40
22	Makine kapesse per dokumenta 24/6	cope	80
23	Tela makine 24/6	cope	100
24	Vinovil 100gr shishe	cope	40
25	Zarfa A4 me flluska ajri brenda	cope	5000
26	Toner Hp OfficeJet Pro 7720 Black Cartridge, NR.953	cope	10
27	Toner Hp Office Jet Pro 7720 Cyan Cartridge, NR.953	cope	10
28	Toner Hp OfficeJet Pro 7720 Yellow Cartridge, NR.953	cope	10
29	Toner Hp OfficeJet Pro 7720Magenta Cartridge, NR.953	cope	10
30	Toner PrinteriHP Pro LaserJet MFP M225dw, PN CF283X/ CF283XC	cope	30
31	Toner Printeri HP Pro LaserJet MFP M227fdw, PN CF230X/CF230XC	cope	120
32	Leter Rrula kase fiskale 57mm x 30m	pako/10 cp	100
33	Flash driver 32 GB me skanim te shenjes se gishtit, Type C3.2	cope	40
34	Flash driver 64 GB me skanim te shenjes se gishtit, Type C3.2	cope	30
35	Bateri per telekomande AA 1.5v LR6 (e madhe)	cope	50
36	Bateri per telekomande AAA i .5v LR03 (e vogel)	cope	50
37	Skoc letre 50mm-52mm x gjatesi min. 50m	cope	50

38	CD Rom 700MB pako me 50cp	pako	20
39	Vizore Plastike 30 cm	cope	30
40	Kapese aktesh me veshe 32 mm 12 cope/pako	pako	100
41	Kapese aktesh me veshe 51 mm 12 cope/pako	pako	100
42	Maus Optical USB	cope	10
43	Tastiere USB	cope	10